



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Fondi Shqiptar i Zhvillimit**  
**Këshilli Drejtues**

---

**VENDIM**

Nr. 291, datë 18.03.2026

**PËR**

**MIRATIMIN E FORMAVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET FSHZH-SË DHE  
NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE, INSTITUCIONEVE PUBLIKE  
APO AKTORËVE TË TJERË TË ZHVILLIMIT**

Në mbështetje të neneve 4, 5, 6, 8 dhe 11, të ligjit nr. 10 130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit" të ndryshuar; ligjit nr. 102/2020, datë 29.7.2020, "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin"; të shkronjës "a", pika 1 e nenit 4, të Statutit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, miratuar me VKD nr. 82, datë 17.7.2009, të ndryshuar; Këshilli Drejtues, pasi analizoi relacionin e paraqitur, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Korçë, aktorë të zhvillimit, nëpërmjet krijimit të një personi juridik, në njërën nga format e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi, me qëllim realizimin, administrimin, menaxhimin dhe operimin e projektit "Jetëzimi i Aeroportit turistik dhe sportiv Korçë".
2. Miratimin e vazhdimit të operimit dhe zgjerimin e zhvillimit të veprimtarisë së "Operatori i Rrugëve Rurale dhe Turistike (ORRT)" sh.b.b., krijuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 255 prot., datë 31.1.2024, sipas objektit të veprimtarisë dhe në funksion të realizimit të ndërhyrjeve të koordinuara për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve rurale, turistike dhe bujqësore.
3. Miratimin e pjesëmarrjes së Fondit Shqiptar të Zhvillimit në Akademinë e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA), në cilësinë e anëtarit të kësaj organizate, krahas pjesëmarrjes së Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH-së në Komitetin Drejtues të saj, me qëllim dhënien e kontributit në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të administratës së njësive të vetëqeverisjes vendore.

4. Miratimin e bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkisë Kolonjë, dhe aktorë të tjerë të zhvillimit, nëpërmjet krijimit të një personi juridik në formën e një Shoqërie të Bashkëpunimit Bujqësor (sh.b.b.), me qëllim realizimin, administrimin, menaxhimin dhe operimin e projektit “Ferma e Arrorëve Kolonjë”.
5. Miratimin e bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe aktorëve lokalë të zhvillimit në zonat Vermosh dhe Valbonë, nëpërmjet krijimit të një personi juridik ose strukture bashkëpunimi, në njërin nga format e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi, me qëllim zhvillimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të integruara të turizmit të qëndrueshëm.
6. Miratimin e bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Bashkisë Durrës, dhe aktorëve të zhvillimit, nëpërmjet krijimit të një personi juridik në njërin nga format e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi, me qëllim zhvillimin dhe administrimin e modelit pilot të standardizuar të menaxhimit të plazhit në Gjirin e Lalzit.
7. Miratimin e bashkëpunimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, njësite të vetëqeverisjes vendore, institucioneve publike dhe aktorëve të zhvillimit, nëpërmjet krijimit të një personi juridik në njërin nga format e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi, me qëllim administrimin, zhvillimin dhe jetëzimin e qëndrueshëm të aseteve të rindërtimit.
8. Autorizimin e Drejtorit Ekzekutiv të Fondit Shqiptar të Zhvillimit për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, përfshirë përgatitjen dhe nënshkrimin e akteve dhe dokumentacionit përkatës, kryerjen e të gjitha procedurave për pjesëmarrjen/krijimin e personit juridik përkatës, si dhe çdo veprim tjetër të nevojshëm në funksion të realizimit të bashkëpunimit ndërmjet palëve përgjatë të gjithë ciklit.
9. Shfuqizimin e Vendimit nr. 152, datë 15.12.2016, të Këshillit Drejtues të FSHZH, “Për miratimin e themelimit të një shoqërie aksionere ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Korçë”.
10. Ngarkohet Fondi Shqiptar i Zhvillimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ALBANA KOÇIU**

**Zëvendëskryeministër**

**Kryetar i Këshillit Drejtues të FSHZH-së**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KOLONJË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 60, Datë 21.04.2026**

**“PËR MIRATIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT DHE STATUSIT TË SHOQËRISË SË  
BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR”**

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 9, si dhe të nenit 54, shkronja “d”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, si dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Kolonjë në mbledhjen e tij të datës 21/04/2026

**VENDOSI:**

- 1.Miratimin e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor, të cilat do të nënshkruhen nga anëtarët themelues, Bashkia Kolonjë;“Green Kolonja” SHA; Fondi Shqiptar i Zhvillimit; Agjencia Ekonomike Mbështetëse (AEM) sh.p.k.; Agjencia e Menaxhimit të Investimeve (AMI) sh.p.k.; HUBEX – Qendra e Ekselencës për Dijën dhe Inovacionin; AGREGATORI – Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqenie.
- 2.Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për nënshkrimin e Aktit të Themelimit, Statutit, si dhe të çdo akti tjetër të nevojshëm për krijimin, regjistrimin dhe funksionimin e Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor, në cilësinë e përfaqësuesit të anëtarit themelues, Bashkisë Kolonjë.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike e Bashkisë Kolonjë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**Vota Pro 11**

**Vota Kundër 0**

**Abstenim 0**

**Zbardhur me datë 21.04.2026**

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**ÉRALDO XHELILI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA KOLONJE**

**Projekt –Vendim**

NR 60, DATË 17.04.2026

**“PËR MIRATIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT DHE STATUSIT TË SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR”**

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 9, si dhe të nenit 54, shkronja “d”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, si dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Kolonjë,

**PROPOZOI:**

- 1.Miratimin e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor, të cilat do të nënshkruhen nga anëtarët themelues, Bashkia Kolonjë;“Green Kolonja” SHA; Fondi Shqiptar i Zhvillimit; Agjencia Ekonomike Mbështetëse (AEM) sh.p.k.; Agjencia e Menaxhimit të Investimeve (AMI) sh.p.k.; HUBEX – Qendra e Ekselencës për Dijën dhe Inovacionin; AGREGATORI – Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqenie.
- 2.Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për nënshkrimin e Aktit të Themelimit, Statutit, si dhe të çdo akti tjetër të nevojshëm për krijimin, regjistrimin dhe funksionimin e Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor, në cilësinë e përfaqësuesit të anëtarit themelues, Bashkisë Kolonjë.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike e Bashkisë Kolonjë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**KRYETAR**  
**Erion ISAI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË

Nr. 2049/Prot

Ersekë, më 30.03.2026

RELACION  
PËR  
PROJEKT-VENDIM

Nr. 60 Datë 17 /04/ 2026

**PËR MIRATIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT DHE STATUSIT TË SHOQËRISË SË  
BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR”**

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Bashkia Kolonjë në funksion të qëllimit dhe misionit të saj, si dhe në mbështetje të iniciativave të ndërmarra në bashkëpunim me FSHZH, do të angazhohet për të marrë pjesë në projektin për krijimin e Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor në Ersekë.

Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor Ersekë do të shërbejë si një qendër bashkëpunimi dhe inovacioni funksionale që krijon sinergji mes fermerëve, bizneseve dhe institucioneve, duke ndihmuar në zhvillimin e ekonomisë lokale të zonës dhe që mund të replikohet si praktikë e suksesshme në çdo komunitet tjetër rural.

Veprimtaria e Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor do të jetë e fokusuar në fushën e prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore si arra, lajthi, bimë medicinale dhe bletari dhe ajo do të funksionojë si një eko-fermë e integruar, duke bashkuar kultivimin, përpunimin, paketimin dhe tregtimin e produkteve bio me origjinë lokale.

Objekti i aktivitetit të SHBB do të jetë i fokusuar në:

- Ofrimin e veprimtarisë të punimit të tokës dhe agregatëve bujqësorë;
- Bashkëpunimin në fushën e prodhimit bujqësor dhe nënprodukteve të tyre, në marketing dhe gjetjen e tregjeve;
- Bashkëpunim për inputet si dhe në konsumin e lëndëve dhe mallrave;

- Ofrimin e shërbimeve të konsulencës për anëtarët dhe jo vetëm;
- Ofrimin e shërbimit të sigurisë së objektit dhe informimit.

Bashkia Kolonjë, Shoqëria “Green Kolonja” sh.a dhe FSHZH së bashku me operatorët e tij do të kontribuojnë duke mbështetur veprimtarinë e Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor, përmes por jo vetëm:

- Programeve dhe ndërhyrjeve konkrete, lëndët e para, pajisjet bujqësore, linja prodhimi dhe/ose përpunimi, etj;
- Konsulencave, ekspertizave, analizave, të dhënave teknologjike etj;
- Ngritjes së kapaciteteve dhe logjistikës;
- Platformave dhe shërbimeve teknologjike;
- Bërjes bashkë të aktorëve, mbledhjes së kontributeve nga palët e treta, etj;
- Promovimit, marketingut dhe sigurimit të tregut për produktin konkret.

Kontributi i Bashkisë Kolonjë në kapitalin themeltar të SHBB do të jetë 30% përqind ose 30,000 (tridhjetë mijë) lekë.

Sa më sipër, ju paraqitet për miratim projektvendimi për miratimin e themelimit të Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor në bashkëpunim me FSHZH.

Duke ju falenderuar për vëmendjen dhe bashkëpunimin,

**KRYETARLI BASHKISË**

**ERION ISAI**



Kr. Prot. 2972  
Dt. 12.5.2026



Jetaror i Këshillit të Bashkisë Kolonjë  
Kryetari i Këshillit të Bashkisë Kolonjë  
Fehriqe Basha Klok

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Korçë, më 08.05.2026

Nr. 536 Prot.

Lënda : Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit

KËSHILLIT TË BASHKISË KOLONJË

KRYETARIT TË BASHKISË KOLONJË

Mbështetur në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar, pas verifikimit të vendimeve nr. 54, nr. 57, nr. 58, nr. 59, nr. 61, nr. 63 dhe nr. 65, datë 21.04.2026 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë, **konfirmohet bazueshmëria ligjore e tyre**, bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, nenet 54 dhe 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e palujtshme të shtetit”, të ndryshuar, ligjin nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të palujtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore, të ndryshuar, ligjin nr.20/2020 “Për përfundimin e procedurave të kalimit të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 500, datë 14.08.2001 të Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të palujtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 07.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtjen e hartës kadastrale”, ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, ligjin nr.152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, të ndryshuar, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1186, datë 24.12.2020 “Për miratimin e listës së objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike, pranë të cilave ngrihen stacionet e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 807, datë 28.12.2023 “Për planin kombëtar të emergjencave civile”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”, ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, urdhërin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 281, datë 30.12.2015 “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 2, datë 14.01.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 8.7.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në lidhje me vendimet nr. 55, nr. 60 dhe nr. 64 datë 21.04.2026, të Këshillit të Bashkisë Kolonjë të depozituar pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë, konstatojmë se këto vendime **nuk përbëjnë akte me karakter normativ** dhe, për rrjedhojë, **nuk i nënshtrohet verifikimit të ligjshmërisë nga institucioni i Prefektit**, në kuptim të nenit 3, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 4, pika 1, nenit 8, gërma “a”, dhe nenit 16, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, të ndryshuar, si dhe nenit 13, pika 2, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**P R E F E K T I**  
**F L O R I N D A Z E G U L L A J**





## VENDIM

Nr. 1, datë 5.5.2026

### PËR MIRATIMIN E THEMELIMIT TË SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR "ARRKO"

Në mbështetje të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001, "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar; nenit 8 të Statutit të AGREGATORI-Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqeverisje, regjistruar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë nr. 1814, datë 14.04.2023; si dhe relacionit të paraqitur nga Drejtori Ekzekutiv i AGREGATORI, Bordi i Drejtorëve,

#### VENDOSI:

1. Të marrë pjesë si anëtar në Shoqërinë e Bashkëpunimit Bujqësor "ARRKO".
2. Miratimin e Akt Themelimit të Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor "ARRKO", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Miratimin e Statutit të Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor "ARRKO", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Autorizimin e Drejtorit Ekzekutiv të AGREGATORI për nënshkrimin e akteve të nevojshme për themelimin, regjistrimin dhe funksionimin e kësaj shoqërie.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### BORDI I DREJTORËVE

**Dritan AGOLLI**  
(Kryetar)



**Dritan RRESHKA**  
(Anëtar)

**Fatjon NANAJ**  
(Anëtar)

**Arben SKËNDERI**  
(Anëtar)

**Ilda KUÇOVA**  
(Anëtar)

**VENDIM**Nr. 1, datë 05.05.2026**PËR****MIRATIMIN E THEMELIMIT TË SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR  
"ARRKO"**

Në mbështetje të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001, "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar; nenit 8 të Statutit të HUBEX-Qendra e Ekselencës për Dije dhe Inovacion, regjistruar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 1753, datë 15.09.2022, me NUIS M22123451W; si dhe relacionit të paraqitur nga Drejtori Ekzekutiv i HUBEX, Bordi i Drejtorëve,

**VENDOSI:**

1. Të marrë pjesë si anëtar në Shoqërinë e Bashkëpunimit Bujqësor "ARRKO".
2. Miratimin e Akt Themelimit të Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor "ARRKO", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Miratimin e Statutit të Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor "ARRKO", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Autorizimin e Drejtorit Ekzekutiv të HUBEX për nënshkrimin e akteve të nevojshme për themelimin, regjistrimin dhe funksionimin e kësaj shoqërie.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**BORDI I DREJTORËVE**

**Dritan AGOLLI**  
(Kryetar)



**Dritan RRESHKA**  
(Anëtar)

**Fatjon NANAJ**  
(Anëtar)

**Arben SKËNDERI**  
(Anëtar)

**Ilda KUÇOVA**  
(Anëtar)